1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
 3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës
- Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit
- Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	<i>7</i>
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Origjina e mallit
1.					
2.					
3.					
4					
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikime teknike per Lotin 1:

Nr	Emertimi	Pavioni	sasia (cope)
1	Aparat Anestezie	Salla Operacioni Urgjence	1
2	Shtrat Operator (per Sallen Operacion Urgjence	Salla Operacioni Urgjence	1
3	Llampe Satelite	Salla Operacioni Urgjence	2
4	Elektrobisturi	Salla Operacioni Urgjence	1
5	Defibrilatopr	Salla Operacioni Urgjence	1
6	Monitor	Salla Operacioni Urgjence /Kirurgji	1

1. Aparat Anestezie

- Fuqia hyrese 100 deri 240 VAC , 50-60 Hz, 70 VA
- Koha e funksionimit me bateri te ngarkuar plotesisht minimumi 45 minuta (deri ne 120 min)
- Gama e treguesve te rrjedhjes se gazit 0.0 deri ne 12 litra \ min (toleranca \pm 10%)
- Flush O2 makssimumi 75 L/min ne 87 psi (6kPA x 100)
- Menyra e funksionimit ventilim i kontrolluar me volum, ventilim i kontrolluar me presion (opsionale), mbeshtetja e presionit (opsionale), SIMV-PS (opsionale), ventilim manual, frymarrje spontane.
- Frekuenca e frymemarrjes 4 deri ne 60 bpm (1/min) (toleranca \pm 10%)
- Presioni pozitiv ekspirator ne fund (PEEP) 0 deri ne 20 cm H2O (hPA) (toleranca \pm 10%)
- Raporti frymezim-skadim (Ti:Te) 4:1 deri ne 1:4
- Kufizimi i presionit (Pmax) 15 deri ne 70 cmH2O (hPA) (toleranca \pm 10%)
- Volumi Tidal (Vt) 20 deri be 1400 mL ne kontrollin e volumit, 20 deri ne 1100 mLne SIMV-PS
- Pauze frymezimi 0 deri ne 50%
- SIMV koha frymezuese 0,3-4,0 sek
- Presioni frymezyses (Pinsp) PEEP + 5 deri ne 65 cm H2O (hPA)
- Rrjedhja frymezuese (Insp Flow) 10 deri ne 75L-min ne modalitetin e kontrollit te volumit dhe presionit, 10 deri ne 85 L-min ne modalitetin e mbeshtetjes me presion dhe SIMV-PS
- Niveli imbeshtetjes se presionit (PPS) PEEP + 3 deri ne 20 cmH2O (hPA)
- Min. Frekuenca per ventilim apno (frekuenca minimale) 3 deri ne 20 bpm dhe OFF
- Niveli i Trigger 2 deri ne 15 L-min(toleranca \pm 10%)

- Funkcionet e integruara te sigurise kontrolluesi i ndjeshem i raportit te oksigjenit (S-ORC) garanton perqendrimi minimal i O2 prej 23% ne nje perzierje O2-N2O. Nderprerja e N2O nese valvula e gazit te O2 eshte e mbyllur ose nese rrjedhja e O2 eshte me e vogel se 0.2L-min. Tregim i degjueshem dhe vizual (LED qe pulson me ngjyre te kuqe) ne rast se presioni i O2 bie nen 1,38bar (20 psi)+- 0.27 bar (4psi). Ne rast deshtimi te rrymes dhe baterise, te kete ventilim manual. Valvula lehtesuese e sigurise me presion te larte hapet ne 75 +- 5 cm H2O (hPA). Valvula e lehtesimit te sigurise me presion negativ hapet ne -8+- 2cmH2O (hPA).
- Monitorimi i vazhdueshem i perqendrimit te O2 ne fryme (opsionale), frekuenca e frymemarrjes, skadimi i vellimit te batices (Tidal volume expiration), minute ekspirative vellimi, presion maksimal i rrugeve te frymemarrjes, PEEP dhe perzgjedhja e mesatares.
- Gama e volumit te minutes se eksplorimit 0 deri ne 99L-min
- Ekran i kontrollit 6-8 inch. (toleranca \pm 10%)
- Vellimi i te gjitha sistemit kompakt te frymemarrjes, me absorbues
- Vellimi i absorbuesit te CO2 standart bombul riperdorshem 1-2l
- Montimi ne krahun rrotullues majtas ose djathtas lartesia e rregullueshme
- Furnizimi me gaz O2, N2O, ajer
- Zgjedhja e cilindrave O2,N2O, ajer

Aksesore te perfshire:

- Sodalime 5 litra ose 3 mbushje te depozites se aparatit
- 2 aparat Avullues (Vaporizers) me Izofluorane dhe Sevofluorane
- 3 Qark (set tubash) pacienti Adult
- 3 qark (set tubash) pacienti Pediatrik
- Tubat e ajrit, okigjenit dhe N2O me porte Afnor per lidhjen me panelin e spitalit

2. Shtrat Operator

- Tabela operative universale, rregullim me një prekje të tre pozicioneve, elektromekanik, elektrohidraulike, të larta/të ulëta, anësore dhe në Trendelenburg. Të gjitha rregullimet të jene te rregullueshme edhe në mënyrë individuale përmes pompës Hidraulike të këmbës
- Baza te jete celik inox
- Dyshek
- E pajisur me njësinë e kontrollit të urgjencës
- Përshtatja 75-105 cm
- Gjatësia jo më pak se 210 cm duke përfshirë pjesën e kokës
- Trendelenburg/i kundërt Trendelenburg: $>25^\circ$
- Rregullimi i seksionit të pasmë -50° në $+75^\circ$
- Rregullimi anësor $>20^\circ$
- Gjerësia e tavolinës për afërsisht: 50-60 cm
- Pozicionet e refleksit/përkuljes: 110/220 °
- Ngarkesa maksimale e sigurt deri në 250 kg
- E pajisur me bateri rezervë
- Përfshirë aksesoret:
- Mbështetësja e kokës, me anim me dorë me ndihmën e servo, e shkëputshme me shtypjen e një butoni
- 2 Seksione ndarese te këmbës 2 (çifti), i ndarë, i rrotulluar dhe i palosshëm, i ndihmuar nga shërbimi, me kompensim të integruar të peshës.
- 2 x jastëk me shkumë mbështetëse krah, antistatike, 450 mm e gjatë, me rrip dhe kapëse ngjitëse,
- Rrip mbajtës trupi, me elementë ngjitës çeliku inox,
- Kornizë anestetike, çelik inox, me mbrojtje nga kthesa, e rregullueshme nga lartësia, me kapëse
- 2 x Mbështetës për këmbët (Tipi Geopel) jastëk integral shkumë i zi, antistatik, me rrip fiksimi, çelik inox 18/10,
- 2 mansheta (kapese), i përshtatshëm për shtylla me diametër 16 deri në 18 mm, çelik inox
- Unaza e kokës me xhel e mbyllur, madhësia e të rriturve, mbron kokën edhe gjatë operacionit në pozicionin shtrirë,

- Mbështetëse e kokës ne formen e patkoit ose e rrumbullaket , me dy pjesë e rregullueshme në gjerësi, mbështetëse koke PU me jastëk të shkëputur dhe rrip mbajtës, optimale

3. Llampe Qendrore Satellite

- Sistem ndriçimi operativ i montuar në tavan i cili perbehet nga dy koka me madhesi nga 60-70 cm ku kemi :
- Një dritë kryesore me ndricim nga 40.000 deri ne 150.000 lux dhe një llampe satelit me ndricim nga 40.000 deri ne 100.000 lux ne distance 1 m
- Llampa kryesore me karakteristika
- Temperatura kolorit 4000grade K-5000grade K
- Madhesia e fushes 18-25 cm
- Distanca e punes 70-140 cm
- Llampa satelit me karakteristika
- Temperatura kolorit 4000grade K-5000grade K
- Madhesia e fushes 15-20 cm
- Distanca e punes 70-140 cm
- Fokusimi me doreza qe sterilizohen
- Levizja e llampave me rrotullim horizontal,
- Me artikulum vertikal dhe rrotullim vertikal
- Thellesia ndricimit ((L1+L2(20%)) 120cm -130 cm
- Burimi ndricimit me llampa led me te pakten 30.000 ore pune
- Me bateri , furnizimi me energji 240V, 50Hz

4. Elektrobisturi

- Duhet të ketë ndërfaqe operatori te aksesueshme për përdoruesit, te jete e shpejte si dhe te kete siguri në përdorimin e përditshëm.
- Ekran me prekje ergonomike të ndërfaqes së operatorit
- Ekranin me madhësinë më të vogël të ekranit 6-8"
- Të paktën një program bazë dhe 40 në shumicën e vendndodhjeve të memories për programet e përcaktuara nga përdoruesi
- Të paktën 15 lloje të ndryshme të rrymës për të gjitha fushat mjekësore dhe specializimet
- Një konfigurim i vetëm sistemi që mbulon të gjitha fushat mjekësore
- Me dalje monopolare dhe bipolarë
- Prerje monopolare, e kontrolluar deri në 400 watts
- Prerje bipolarë me gërshtë bipolarë
- Koagulimi bipolar me funksione automatike
- PCS – Sistemi i Kontrollit të Pacientit me treguesin “kontakt” (grafik) NE (Elektrodë Neutrale) garanton monitorimin e NE në nivelin më të lartë të sigurisë
- Funksioni për Baby NE për rritjen e sigurisë në kirurgjinë pediatrike
- Mundësia e ndërrimit të programeve nëpërmjet çelësit të këmbës ose dorezës me çelsat me dy gishta
- Fuqia prerëse të paktën 400 Watt
- Fuqia e koagulimit të paktën 200 Watt
- Lloji i pjesës së aplikuar CF: rezistente ndaj defibrilimit
- Duhet te jete e pajisur me pllake tokzimi

Aksesorët që do të përfshihen:

- Foot switch, double pedal
- Elektroda neutrale e disponueshme për pacientin (50 komplete me një përdorim)
- Kabullo për elektrodë neutrale të disponueshme
- Dorezë lapsi për aplikime monopolare me çelës
- Set elektrodash GJIPËRË, THIKË, LANCET, TELI, TOP, ELECTR., MIKRO, të paktën 5 për secilën të përputhshme me dorezën e mësipërme
- Kabullo bipolare dhe monopolare
- Gërshërë bipolare të hollë
- Pinca bipolare

5. Defibrilator

- Forma valore: Eksponenciale e cunguar dyfazore (bifazik). Parametrat e rregulluar të formës valore si funksion i impedancës së pacientit.
- Energjia maksimale që duhet të jetë: 200 xhaul për dyfazore (bifazik)
- Dorezat e goditjes me jastëkë elektrodash
- Saktësia e rëndë e lëshuar $\pm 10\%$ ose $\pm 1J$ cilado qoftë më e madhe për të gjitha teknikat e duhura.
- Më pak se 5 sekonda në nivelet e rekomanduara të rritjes (150 Joules) me një bateri të re të ngarkuar
- Më pak se 6 sekonda në nivelet e zgjedhura të fituara (deri në 200 Xhaul) me një bateri të re,
- Brezi i rezistencës së pacientit, minimumi: 25 ohm (defibrilimi i jashtëm) Maksimumi: 250 ohm.
- Çelësi i aktivizimit/fikjes së terapisë, ngarkimi, shoku, sinkronizimi, zgjedhja e lidhjes me EKG, Zgjedhja e pacientit, Printimi, Regjistrimi i ngjarjeve, Raportet, Alarmet
- Kontrolli i ngarkimit: Butoni i panelit të përparmë dhe butoni i jashtëm i Goditjes
- Kontrolli i goditjes: Butoni i panelit të përparmë dhe butonat në butonat e lopëve dorezave goditese të jashtme ose butonat dorezave goditese të brendshme
- Goditje e sinkronizuar
- Treguesit për: njoftimet me tekst, sinjalizimet audio, sinjalet QRS, statusi i baterisë, gati për përdorim (RFU), energjia elektrike, modaliteti i sinkronizimit
- Treguesit e gjendjes "të armatosur gati për goditje" duhet të përfshijnë: tonin e karikimit, butonin e ndezjes në panelin e përparmë dhe të jashtme, nivelin e fuqisë të treguar në ekran.
- Terapia me AED është e mundur me një nivel energjie prej të paktën 150 J
- Teksti dhe zëri në modalitetin AED: Mesazhe me tekst dhe zë të përmirësuar që e drejtojnë përdoruesin përmes një protokollit të konfiguruar nga përdoruesi
- Deri në 3 valë EKG mund të shihen në ekran dhe deri në dy valë mund të printohen njëkohësisht.
- EKG-ja e marrë nga pads merret përmes 2 elektrodave të pads multifunksionale.
- Mesazhet e gabimit shfaqen në ekran për tastierë ose lidhje
- Leximi dixhital i rrahjeve të zemrës në ekran nga 16 deri në 300 rrahje/minutë (të rritur) ose 16 deri në 350 rrahje/minutë (fëmijë), me një saktësi prej $\pm 10\%$ ose ± 5 rrahje/minutë, cilado qoftë më e madhe.
- Alarmet e zemrës / Aritmia: Puls i lartë / i ulët, asistoli, VFIB / V-TACH, VTACH, Tachy ekstrem, Brady ekstreme, shkalla PVC, ritmi nuk kap, pacer pa ritëm
- Madhësia e ekranit: të paktën 7 inç me një rezolucion prej 800 x 480 piksele
- Bateria: e rikarikueshme.
- Kapaciteti: Me një bateri të re të ngarkuar plotësisht për të siguruar:
 - të paktën 100 cikle ngarkimi/goditjeje me fuqi të plotë ose 2,5 ore me bateri në monitorim
 - E pajisur me një printer termik me gjerësi të paktën 50 mm. Tasti i printimit fillon dhe ndalon shiritin. Printeri mund të konfigurohet të printojë në kohë reale ose me 10 sekonda vonësë

Aksesoret:

- Kabull EKG
- Bateria

-
- Leter termike

6. Monitor

- Monitorimi i pacientit për te rritur, pediatrikë dhe neonat.
- Konfigurimi duhet të përfshijë:
- Ekran LCD me ngjyra 10-15 inç me ekran të gjerë rezistent me prekje,
- Buton rrotullues,
- 12 forma valesh max,
- paraqitjet e ekranit të zgjedhura nga përdoruesit,
- 3/5 kanale EKG
- aritmia bazë (përfshirë asistolën, fibrilimin ventrikular, bradikardi ekstreme, takikardi ventrikulare, takikardi ekstreme, PVC në minutë),
- Analiza ST,
- Harta e ST,
- impedancë e frymëmarrjes,
- SPO2
- presioni joinvaziv i gjakut (NIBP),
- temperatura e dyfishtë e vazhdueshme,
- Mini trendet 8 ore,
- 240 orë ngatendence,
- Dalja analoge e EKG-së,
- Mbështetje për ekranin e jashtëm VGA, modaliteti i natës që lejon ndriçimin e ekranit dhe kontrollin e volumit të altoparlantit veçanërisht për kohën e natës.
- Monitori duhet të jete i pershtatshem ne perdorim per salle kirurgjikale :
Aksesor te perfshire
- 3 kablllo EKG
- Sensori SpO2 i rritur +sensor pediatrik+sensor neonat
- manshetë NBP për të rritur dhe kabell NBP + pediatrik
- Bateri, Përfshirë një bateri litium-jon për të lejuar monitorin e pacientit të ndizet gjatë transportit brenda spitalit ose gjatë humbjes së energjisë AC me të paktën 6 orë kohë rezervë
- Sonda e temperaturës së ezofagut/rektalit, Sonde shume perdorimshe per matjen e temperatures Ezofageal/Rektale; madhësia = 10-15 Fr; me gjatësi të paktën 3 m
- Sonda e temperaturës së sipërfaqes së lëkurës, Temperatura e sipërfaqes së lëkurës sonde e ripërdorshme; gjatësia e sondës të paktën 3 m

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikime teknike per Lotin 2

➤ **Loti 2:**

Lista e pajisjeve mjekesore te kerkuara - Salla operacionit Okulistike

Nr	Emertimi	Pavioni	sasia (cope)
1	Yag Laser	Salla operacionit Okulistike	1

1. Yag Laser

- Duhet te jete lazer Okulistik me teknologjine YAG per kapsulotomine dhe Iridotomine
- Duhet te kete gjatesi vale te pakten deri ne 1064 nm
- Te kete energjine nga 0.3 deri ne 10 mJ per pulsime, e vazhdueshme variable
- Kohezgjatja e pulsimit jo me pak se 4 ns
- Shpejtesia e Goditjes jo me pak se 3 shkrepte per sekonde per nje shpejtesi dhe eficence trajtimi
- Modaliteti i goditjes te jete I perzgjedhshem per 1, 2 dhe 3 impulse per goditje,
- Madhësia e pikes se goditjes jo me e madhe se 8 µm
- Këndi i konit duhet te jete te pakten 16 gradë
- Kompensimi (Posterior) duhet te jete 100 deri në 350 µm, vazhdimisht e ndryshueshme
- Rrezja e goditjes duhet te jete e kuqe 635 nm, me intensitet te rregullueshem
- Shpejtësia e përsëritjes duhet te jete deri në 3 Hertz
- Zmadhimi duhet te jete i optimizuar për vizualizimin e përmirësuar të segmentit të përparmë
- Duhet te kete ftohje me Ajer
- Përmasat duhet te jene jo me shume se Lartesi 57 x gjeresi 75 x thellesi 44 cm,
- Duhet te perfshije aksesoret standart si tavolina, ekran te levizshem, syze sigurie, shenjë sigurie per lazer, mbulesë kunder pluhurit
- Te mundesoje perditesimin me video kamera, tonometer etc
Aksesore
- Te jet e perfshire lente per iridectomy
- Me bateri

Afati I levrimit te mallit

Afati i levrimit të jetë 30 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontrates

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)
(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT (i njejte per te 2 lotet)

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës së mëposhtme.

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit të jetë 30 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

(I NJEJTE PER TE 2 LOTET)

➤ **Loti 1:**

Lista e pajisjeve mjekesore te kerkuara - Salla Operacioni Urgjence

Nr	Emertimi	Pavioni	sasia (cope)
1	Aparat Anestezie	Salla Operacioni Urgjence	1
2	Shtrat Operator (per Sallen Operacion Urgjence	Salla Operacioni Urgjence	1
3	Llampe Satelite	Salla Operacioni Urgjence	2
4	Elektrobisturi	Salla Operacioni Urgjence	1
5	Defibrilatopr	Salla Operacioni Urgjence	1
6	Monitor	Salla Operacioni Urgjence /Kirurgji	1

➤ **Loti 2:**

Lista e pajisjeve mjekesore te kerkuara - Salla operacionit Okulistike

Nr	Emertimi	Pavioni	sasia (cope)
1	Yag Laser	Salla operacionit Okulistike	1

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT – (I NJEJTE PER TE 2 LOTET)

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (I NJEJTE PER TE 2 LOTET)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas **Shtojcës 2**;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8**;
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: **(I NJEJTE PER TE 2 LOTET)**

- Licence e leshuar nga QKL ose QKB për tregëtim me shumicë të barnave .

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **(I NJEJTE PER TE 2 LOTET)**

- a) **Kopje të deklaratave të xhiros vjetore** për 3 (tre) vitet e fundit (**2019, 2020, 2021**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete **jo më e vogël se 40 % e vlerës së pritshme të kontratës për të cilën konkuron operatori ekonomik.**
- b) **Kopje të certifikuara/vërtetuara të bilanceve për vitet 2019, 2020 dhe 2021** të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet;
- c) **Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kontratës për të cilat konkurren operatorit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**
 - **Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shihen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, të shihen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.**
 - **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shihen datat.**

2.3 Kapaciteti teknik: **(I NJEJTE PER TE 2 LOTET)**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtim të pajisjeve mjekësore.
2. Të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinier në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej furnizim vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, certifikatës/certifikatave së trajnimit sipas aparaturës që furnizon, CV-së, kontratës individuale të punës. Inxhinjeret duhet të figurojnë në listpagesa në momentin e hapjes së ofertave
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.
4. Ofertuesi duhet të paraqesë për pajisjen mjekësore objekt prokurimi, certifikatën CE ose deklaratën e konformitetit (sipas kategorizimit përkatës) për aprovim të standarteve, direktivave në tregun Europian, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.
5. Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklaratë që pajisja e shoqëruar me aksesorët përkatës objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura dhe prodhim i viteve të fundit (2020-2022). Ky kriter të plotësohet sipas formularit të vetëdeklarimit.

-
6. Operatori ekonomik duhet te paraqese deklaraten e garancise per pajisjet, ne te cilen duhet te saktesoje se periudha e garancise te jete jo me pak se 1 (nje) vit, sipas afatit te percaktuar ne specifikimet teknike. Ne deklaraten për përmbushjen e afatit të garancisë (një vit garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale).
 7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.
 8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata ISO të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), përkatësisht:
 - me Çertifikatën ISO 9001:2015 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
 - me Çertifikatën ISO 14001:2015 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
 - me Çertifikatën OHSAS 18001-2007 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
 9. Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per pajisjen objekt prokurimi bashke me aksesoret perkates, ne forme table, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet. (Sipas Formularit te Vetedeklarimit)
 10. Operatori do te kryeje furnizimin, instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij. (Sipas Formularit te Vetedeklarimit)
 11. Operatori duhet te trajnoj stafin mjekesor pas instalimit te pajisjeve mjekesore ne pavionet perkatese (Sipas Formularit te Vetedeklarimit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p>

	Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
